



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

Komisioni i Barazisë Gjinore, Mirëqënies Sociale dhe Mosdiskriminimit

Datë 10.11.2025

RAPORT VENDIMMARRJEJE

Projekt-vendimin (titulli i projektvendimit: "PËR MIRATIMIN E FAMILJEVE PËRFITUESE TË NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLOKNDIHMËN EKONOMIKE DERI 6% DHE FONDI I TË ARDHURAVE TË BASHKISË Durrës, PËR MUAJIN SHTATOR 2025.

Baza ligjore:

Në mbështetje të Ligjit nr.139, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Ligjit nr.68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar; Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjit nr.57/2019, "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", i ndryshuar; Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.115, datë 24.12.2024 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2025 dhe programin buxhetor afatmesëm 2025-2027", Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 1, datë 11.02.2025 "Për miratimin e kriterëve për familjet në nevojë, që do të trajtohen me ndihmë ekonomike deri në 6 % të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike si dhe për ato, që do të trajtohen me fonde të buxhetit vendor".

Propozimi nga kryetari/këshilltarët/tjetër (Çfarë propozohet në projektvendim):

Kryetari i bashkisë, sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Shërbimit Social, i propozon Këshillit Bashkiak të shqyrtojë në përputhje me aktet ligjore dhe të vendosë:

1. Miratimin e përfitimit të ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë Durrës për 136 (njëqind e tridhjetë e gjashtë) familje me një fond prej 591.289 (pesëqind e nëntëdhjetë e një mijë e dyqind e tetëdhjetë e nëntë) lekë.

Nr	NJËSITË ADMINISTRATIVE	Nr	Lekë
1	Njesitë Administrative Durrës	87	392.077
2	Njësia Administrative Rrashbull	14	60.006
3	Njësia Administrative Sukth	25	103.776

4	Njësia Administrative Ishëm	1	8520
5	Njësia Administrative Katund i Ri	5	19.980
6	Njësia Administrative Manëz	2	6.930
	Shuma	134	591.289

2. Miratimin e heqjes nga skema e ndihmës ekonomike për këtë muaj gjithsej -0- familje nga fondi i Bashkisë.
3. Miratimin e futjes në skemën e ndihmës ekonomike për muajin Shtator 2025 të 2 (dy) familjeve, të cilat janë në nevojë, në kushte të vështira ekonomike, me probleme të ndryshme sociale dhe do të trajtohen me fond nga të ardhurat e Bashkisë Durrës përkatësisht në vlerat 2178 lekë dhe 3240 lekë.
4. Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi 6 % i fondit të kushtëzuar 36 (tridhjetë e gjashtë) familje me një fond 184.782 (njëqind e tetëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e dy) lekë. Ky fond do të jetë nga fondi i kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike.

Analiza Financiare/ Buxheti total/natyra e financimit (të ardhurat e veta, transferta etj):

Natyra e financimit është me të ardhurat e veta të bashkisë Durrës dhe nga fondi i kushtëzuar 6% për bllok ndihmën ekonomike.

Drejtoria/Spektori përgjegjës që ka përgatitur materialin:

Drejtoria e Shërbimit Social.

Impakti social/grupet që preken:

Familjet të cilat jetojnë në territorin e bashkisë Durrës, të cilat përfitojnë nga fondi i kushtëzuar 6% dhe ato që janë në kushte të vështira ekonomike dhe që përfitojnë nga të ardhurat e bashkisë Durrës.

A është objekt konsultimi: (PO/JO)

JO

Komisioni i përhershëm/përkohshëm i Barazisë Gjinore, Mirëqënies Sociale dhe Mosdiskriminimit, u mblodhë më datë 10.11.2025, dhe shqyrtoi pikën nr. 2 të rendit të ditës, relacionin dhe dokumentat shoqërues të tij.

Komunikimi midis administratës dhe komisionit i përhershëm/përkohshëm:

Komisioni u mblodh sot për pikën nr. 2 të rendit të ditës. Komisioni lexoi pikën dhe pyeti të pranishmit

nese kam pyetje ne hollje me pak.
Anëtarët mull kam pyetje. Ic përbashkët
kam shprehur për publikimin e kësaj
përve për mblidhjen e kësaj
Këshillit

Për sa më sipër, pas shqyrtimit, të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese, Komisioni me shumicë votash, vendosi:

T'i propozojnë Këshillit Bashkiak:

- a- Kalimin e projektaktit në mbledhjen e Këshillit për vlerësimin e mëtejshëm dhe për shqyrtim
- b- Miratimin e projekt aktit
- c- Refuzimin e miratimit të projektaktit
- d- Miratimin e projektaktit me ndryshimet si vijon:
- e- _____

Komisioni i Barazisë Gjinore, Mirëqënies Sociale dhe Mosdiskriminimit

Kryetar

Edlira Shemsi



Zv/Kryetar

Florian Tahiri

Sekretar

Bledar Prizreni



Anëtar

Xhiliola Doçi



Anëtar

Denis Lika

Zëremësuca

H. Pajza

